



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Këshilli i Fakultetit

Ref. nr.

2412

Prishtinë, 16.05.2022

Në bazë të nenit 76 pika 1.8 e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të UP-së nr. 886 dt. 27.4.2022 dhe propozimit të Dekanit të Fakultetit, Këshilli i Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore, në mbledhjen e 34-të, të mbajtur me 12.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave

I. Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave lidhur me pozitat e shpallura konkursin për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" konkretisht në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, konkursi nr. 967 dt. 4.5.2022. Me propozimin e Dekanit të Fakultetit, komisioni formohet në këtë përbërje:

1. Prof. Ass. Dr. Ilir Mazreku, kryetar
2. Prof. Ass. Dr. Ujkan Bajra, anëtar
3. Ass. Msc. Ardita Kurtishaj, anëtare

II. Komisioni sipas pikën I të këtij vendimi, është i obliguar që në afat prej 5 ditëve kalendarike pas përfundimit të afatit për paraqitje të ankesave, të shqyrtoj të gjitha ankesat e paraqitura në afatin ligjor dhe të përpiloj raport dhe propozim konkret për Këshillin e Fakultetit. Raporti i hartuar brenda afatit të lartë cekur, i nënshkruar dhe protokolluar, dorëzohet në arkivin e Fakultetit për Këshillin e Fakultetit.

III. Komisioni i ankesave mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e përcaktimeve dhe rekomandimeve që bënë në bazë të konkursit lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të UP-së nr. 967 dt. 4.5.2022.

IV. Komisioni për shqyrtimin e ankesave është i obliguar që gjatë punës së tij të respektoj dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e UP-së, Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të UP-së nr. 886 dt. 27.4.2022, kushtet e konkursit, aktet e tjera ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të FSHMN-së

Dekani i Fakultetit

Prof. Dr. Idriz Vehapi

